



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 215, datë 31.10.2018

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 79, DATË 31.08.2015
“PËR MIRATIMIN/LICENCIMIN E PERSONAVE PËR TË USHTRUAR
VEPRIMTARINË E AGJENTIT NË SIGURIME, SI DHE RASTET E MOSPRANIMIT
TË REGJISTRIMIT TË TIJ DHE REFUZIMIT TË LICENCËS”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me datë 01.01.2019.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI

Në Rregulloren nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 3, shkronja “c”, ndryshon si vijon:

“c. Nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale. Ndaj tij nuk ka në proces çështje penale në Prokurori apo Gjykatë.”

2. Në nenin 4:

1. Në pikën 1, në shkronjën “d”, në fund shtohet shprehja:

“Dhe vërtetime nga Prokuroria e Gjykata se ndaj tij nuk ka në proces çështje penale”;

2. Pika 3, ndryshon si vijon:

“3. Përveç dokumentacionit të mësipërm, shoqëria e sigurimit depoziton një kopje të kontratës me aplikantin për kryerjen e veprimtarisë së agentit, si dhe kopje të noterizuara të kontratës së qerasë, apo të certifikatës së pronësisë të mjedisit ku do të ushtrohet veprimtaria e agentit.”

3. Në nenin 11, pika 3, shfuqizohet.

4. Në nenin 12, në pikën 1, në fund, shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Monitorimi i përmbushjes së kërkesave bëhet nga Sektori i Mbikëqyrjes së Ndërmjetësve në Departamentin e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve nëpërmjet inspektimeve në vend dhe/ose off site.”